

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7887
E premte, 20 shtator 2024
Çmimi 0.50 €

Ish-kryetari i Prizrenit,
Kadri Kryeziu, dekoron
me mirënjohje Ilir Kullën

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHBA-ja INVESTON NË SERBI, OPOZITA KRITIKON KURTIN PËR CENIM TË RAPORTEVE ME ALEATËT

FAQE 4-5



Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Serbia kanë nënshkruar një marrëveshje për bashkëpunim strategjik në fushën e energjisë në Serbi. Departamenti Amerikan i Shtetit tha se kjo marrëveshje do t'i zgjerojë

mundësitë për kompanitë amerikane për të investuar në sektorin e energjisë në Serbi, përfshirë promovimin e investimeve amerikane që do ta forcojnë partneritetin strategjik ShBA - Serbi. Për këtë

marrëveshje ka reaguar opozita në Kosovë. Përfaqësuesit e PDK-së dhe të LDK-së kanë drejtuar kritika në adresë të qeverisë Kurti, duke theksuar se është duke cenuar partneritetin strategjik të Kosovës me ShBA-në

VON DER LEYEN
TAKON LIDERËT
E BALLKANIT
PERËNDIMOR

F. 5



'IZOLIMI I KOSOVËS DHE
AUTONOMIA E VERIUT',
PSD-JA ILUSTRON
'RRUGËTIMIN E KURTIT'
ME NJË AKSION SIMBOLIK
MBI URËN E IBRIT

F. 5



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mok: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



ENIS VILA: NËSE FTOHEM NGA
KOSOVA, JAM I GATSHËM TA JAP
MAKSIMUMIN

F. 14

OPINION

DIALOGU | MIROSLAV LAJÇAK,
SHFAQJA E NJËANSHMËRISË NË
FAVOR TË SERBISË, SFIDAT PËR
KOSOVËN DHE NEVOJA PËR KOOR-
DINIM TË NGUSHTË ME SHBA-në

F. 7

Shkruan: Prof. dr.
Fejzulla BERISHA



AKTUALE

IZRAELI ZHVENDOS VËMENDJEN
KAH LIBANI DHE HEZBOLLAHU

F. 2

FSK-ja, PJESË E KONFERENCËS
SË 27 TË SHEFAVE TË MBROJTJES
SË INICIATIVËS SHBA - KARTA E
ADRIATIKUT

F. 3

EKONOMI

GËRHXHALIU: QYTETARËT DHE
BIZNESET E BALLKANIT PERËNDIMOR
E DËSHIROJNË INTEGRIMIN DHE
BASHKËPUNIMIN RAJONAL, POR
POLITIKA E PENGON KËTË PROCES

F. 8

PROJEKTLIGJI PËR MBROJTJEN
E KONSUMATORIT DHE AI PËR
KRIPTO-ASETET PROCEDOHEN PËR
NË SEANCË PLENARE

F. 8

SPORT



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

RRUGA "PASHKO VASA", P.N. PRISHTINË, KOSOVË
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Izraeli zhvendos vëmendjen nga Libani dhe Hezbollahu

JERUSALEM, 19 SHTATOR - Ministri i Mbrojtjes i Izraelit e ka shpallur nisjen e një "faze të re" të luftës, teksa Izraeli ka zhvendosur vëmendjen drejt frontit verior kundër Hezbollahut, grupit në Liban të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara.

Dy valë shpërthimesh goditën Sirinë dhe Libanin: sulme që duket se janë kryer nga Izraeli dhe që kanë shënjestruar pejxherët e përdorur nga Hezbollahu. Nga shpërthimet, të martën u vranë të paktën 12 persona dhe u plagosën pothuajse 3 000 të tjerë. Ndërkaq, të mërkurën në mbarë Libanin pati shpërthime të radiolidhjeve dhe pajisjeve të tjera elektronike, që lanë të vrarë të paktën 20 persona dhe plagosën 450 të tjerë. "Ne jemi në nisje të fazës së re të luftës. Kjo kërkon kurajë, vendosmëri dhe



këmbëngulje", tha ministri izraelit i Mbrojtjes, Yoav Gallant, teksa u

takua me ushtarë izraelitë. Kreu i Këshillit ekzekutiv të

Hezbollahut premtoi se grupi libanez do të përgjigjet ndaj

shpërthimeve të pejxherëve përmes një "ndëshkimi të posaçëm".

Hezbollahu kishte nisur sulmet ndaj Izraelit pothuajse menjëherë pasi sulmi i 7 tetorit i Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian - nxiti luftën me Izraelin. Që atëherë, Izraeli dhe Hezbollahu kanë këmbyer zjarr përditë, duke rritur rrezikun për shpërthimin e një lufte në shkallë të plotë.

Ministria e Shëndetësisë në Gazë ka thënë se më shumë se 41 000 palestinezë janë vrarë që kur nisi lufta në Gazë. Kjo ministri nuk bën dallimin mes luftëtarëve të Hamasit dhe civilëve të vrarë, por ka thënë se më shumë se gjysma e të vrarëve ishin gra dhe fëmijë. Izraeli, pa ofruar dëshmi, ka thënë se ka vrarë më shumë se 17 000 militantë.

Rezerva Federale ul normën e interesit, sinjal për fundin e luftës ndaj inflacionit



WASHINGTON, 19 SHTATOR - Rezerva Federale ka ulur normën e interesit me një nivel të pazakontë prej 0,5%. Ky është një ndryshim dramatik pas gati dy vitesh nivelesh të larta të normës së interesit, për të ndihmuar për zbutjen e inflacionit. Norma e lartë e interesit e bëri shumë të shtrenjtë huamarrjen për konsumatorët amerikanë.

Kjo është ulja e parë e normës së interesit në mbi katër vjet dhe reflekton përqendrimin e Rezervës Federale te forcimi i tregut të punës, që ka treguar shenja të qarta ngadalësimi. Ky vendim i marrë vetëm disa javë përpara zgjedhjeve presidenciale, mbart gjithashtu mundësinë e trazimit të

panoramës ekonomike në periudhën gjatë së cilës amerikanët përgatiten ta hedhin votën e tyre.

Vendimi i bankës qendrore e ul normën në 4.8%, nga niveli 5.3% që ishte niveli më i lartë rekord i dy dekadave të fundit dhe që zgjati për 14 muaj me radhë, i projektuar për ta zbutur nivelin më të keq të inflacionit që pati goditur Shtetet e Bashkuara në katër dekadat e fundit. Jo larg objektivit të përcaktuar nga Rezerva Federale, inflacioni arriti në gusht në 2.5%, nga kulmi që pati arritur në mesin e vitit 2022, në 9.1%.

Drejtesit e Bankës Qendrore sinjalizuan, gjithashtu, se mund të vendosin ta ulin sërish me 0.5

% normën e interesit gjatë dy takimeve të fundit të këtij viti, që do të mbahen në nëntor dhe në dhjetor.

Megjithëse Banka Qendrore beson tashmë se është fituar përgjithësisht lufta ndaj inflacionit, shumë amerikanë vazhdojnë të ndihen të zhgënjyer me çmimet e larta të ushqimeve, karburantit, qirave dhe aspekteve të tjera themelore të jetesës.

Ulja e normës së interesit pritet që me kalimin e kohës t'i ulë kostot e huamarrjes për blerjen e shtëpive, makinave dhe marrjen e kartave të kreditit, duke forcuar kështu gjendjen financiare të amerikanëve dhe duke rritur fuqinë e tyre blerëse dhe nivelin e tyre të përgjithshëm ekonomik.

Koreja e Veriut thotë se ka testuar një raketë të re balistike

PHENIAN, 19 SHTATOR - Koreja e Veriut tha se ka testuar një raketë balistike, që pretendon se është e aftë të bartë koka bërthamore "shumë të mëdha". Sipas medias shtetërore, Pheniani ka testuar një raketë lundruese. Udhëheqësi Kim Jong Un ka përcjellë nga afër testimin e "llojit të ri të raketës balistike, Hwasongpho-11-Da-4.5, dhe të një raketë të përmirësuar lundruese".

Gjatë këtij viti Koreja e Veriut ka kryer një sërë testimesh të armëve. Këto testime, sipas ekspertëve, mund të jenë të lidhura me furnizimin e supozuar me armë që

Pheniani dërgon në Rusi, me qëllim që Moska t'i përdorë në luftën kundër Ukrainës. "Lloji i ri i raketës taktike balistike është pajisur me një kokë bërthamore konvencionale, super të madhe, me peshë prej 4.5 tonësh", raportoi agjencia verikoreane e lajmeve, KCNA. Veriu "po ashtu kreu testimin e një raketë strategjike lundruese, performancat e së cilës janë përmirësuar shumë në mënyrë që ajo të përdoret për luftë", tha KCNA-ja. Ushtria e Koresë së Jugut ka thënë se Veriu ka testuar një raketë balistike me rreze të shkurtër veprimi, e cila



fluturoi rreth 400 kilometra në lindje të Gadishullit Korean. Testimi "synonte verifikimin e

saktësisë së goditjes në rreze të mesme prej 320 kilometrash me pajisje të fuqishme shpërthyes dhe me

një kokë bërthamore shumë të madhe", tha KCNA-ja.

Kim tha se testime të tilla janë të nevojshme për "gjendjen e sigurisë" së shtetit të tij. "Situata ushtarake dhe politike në rajon... është tregues se puna për forcimin e kapaciteteve ushtarake për vetëmbrojtje duhet të jetë çështja kryesore", tha ai, sipas KCNA-së.

Së fundi, Koreja e Veriut ka forcuar raportet e tyre. Presidenti rus Vladimir Putin zhvilloi një vizitë në Veri në qershor dhe së bashku me Kimin nënshkruan një marrëveshje dypalëshe të mbrojtjes.

25 vjet TMK, Krasniqi: UÇK-ja, TMK-ja dhe FSK-ja, krenaria jonë

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Me rastin e 25-vjetorit të themelimit të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK),

kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka shkruar në "Facebook" se nga tri shkronjat e arta të UÇK-së, që

bartën luftëtarët e lirisë në zemrën e tyre gjatë periudhës së luftës, në TMK pas saj, e deri sot te tri shkronja të tjera,

të arta po ashtu, FSK, burrat dhe gratë me uniforma të Kosovës kanë qenë dhe janë krenaria jonë.



FSK-ja, pjesë e Konferencës së 27 të shefave të Mbrojtjes së Iniciativës ShBA - Karta e Adriatikut



miratuar deklarata e përbashkët, ku riafirmohet angazhimi për të qëndruar së bashku kundër luftës së paligjshme, të pajustificueshme dhe të paprovokuar të agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, e cila ka shkatërruar paqen dhe stabilitetin në zonën euroatlantike dhe ka dëmtuar rëndë sigurinë në rajonin tonë dhe globalisht. "Ne dënojmë, në termat më të fortë, shkeljen e dukshme të Kartës së Kombeve të Bashkuara nga Rusia dhe ndikimin e luftës së Rusisë në pjesën tjetër të botës. Ne përhëndesim popullin ukrainas për rezistencën e tij të guximshme dhe shprehim simpatinë dhe ngushëllimet tona për humbjen dhe vuajtjen e tyre".

Në deklaratën e përbashkët u theksua: "Ne jemi të përkushtuar për të arritur një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme që mbështet parimet e Kartës së OKB-së, në veçanti sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë. Mbështetja kolektive për Ukrainën konfirmon mirëkuptimin tonë të ndërsjellë se bashkëpunimi me aleatët dhe partnerët është jetik për aftësinë tonë kolektive për t'iu përgjigjur sfidave aktuale dhe të ardhshme".

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Ka mbyllur punimet Konferenca e 27, shefat e Mbrojtjes së Iniciativës ShBA - Karta e Adriatikut (A5), ku bëjnë pjesë Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Shqipëria, Mali i Zi dhe

Maqedonia e Veriut.

Pjesëmarrës në konferencë ishin komandanti i Komandës Evropiane të ShBA-së, njëherësh komandant i Forcave Amerikane në Evropë, gjeneral Christopher G. Cavoli, komandanti i Komandës së Forcës së Bashkuar të NATO-s në Napoli, Itali,

adjutantët e përgjithshëm nga shtetet përkatëse të Programit të Partneritetit të Gardave Kombëtare të ShBA-së. Garda Kombëtare e Ajovës është përfaqësuar nga gjeneralbrigade Mark Kappelman, ndërsa Kosovën dhe FSK-në, në emër të komandantit gjenerallejtënant

Bashkim Jashari, e ka përfaqësuar zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, ku të dy gjeneralët prezantuan vizionin e përbashkët për të qenë pjesë në Kartën e Adriatikut (A5) si dhe bashkëpunimin e deritanishëm dhe planet për të ardhmen. Në kuadër të konferencës është

Osmani shkon në ShBA, do të takohet me liderë botërorë

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka udhëtuar për në Nju-Jork. Në kuadër të Javës së Nivelit të Lartë të sesionit të 79 të Asamblesë së Kombeve të Bashkuara ajo do të zhvillojë takime me liderë botërorë, me organizata ndërkombëtare si dhe aktivitetet të tjera zyrtare. Përgjatë kësaj vizite presidentja në takime me homologët do të diskutojë për zhvillimet e fundit në Kosovë, për përkushtimin e

Republikës së Kosovës për ta forcuar pozitën ndërkombëtare të saj, si dhe për thellimin e raporteve me shtete të tjera në përfitim të qytetarëve tanë. Ajo do të marrë pjesë edhe në aktivitete dhe diskutime të shumta të organizuara nga shtetet aleate. Në agjendën e presidentes Osmani do të jenë edhe një sërë aktivitete të përbashkëta me mërgatën shqiptare në Amerikë si dhe disa nga shoqatat të cilat zhvillojnë aktivitet në ShBA.



Ish-kryetari i Prizrenit, Kadri Kryeziu, dekoron me mirënjohje Ilir Kullën

PRIZREN, 19 SHTATOR - Këshilli Komunal i Prizrenit ka përkujtuar 25-vjetorin e krijimit të saj si komuna e parë e Kosovës së pasluftës, e krijuar më 15 qershor të 1999-s nga

Qeveria e Përkohshme e asaj kohe, ku kryetar ishte emëruar Kadri Kryeziu. Ky i fundit në këtë ceremoni u ka ndarë mirënjohje disa personaliteteve të shquara për kontributin e

dhënë në atë kohë për themelimin dhe funksionimin e komunës së Prizrenit, të parën në Kosovën e lirë, ndër ta edhe Ilir Kullën. Kulla ndër vite ka qenë

zyrtar i lartë në Shqipëri, analist politik dhe gazetar. Ai, gjithashtu, ka qenë veprimtar shumë aktiv gjatë edhe pas luftës së Kosovës dhe gëzon përkrahje në Kosovë.





ShBA-ja investon në Serbi, opozita kritikon Kurtin për cenim të raporteve me aleatët

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Serbia kanë nënshkruar një marrëveshje për bashkëpunim strategjik në fushën e energjisë në Serbi. Departamenti Amerikan i Shtetit tha se kjo marrëveshje do t'i zgjerojë mundësitë për kompanitë amerikane për të investuar në sektorin e energjisë në Serbi, përfshirë promovimin e investimeve amerikane që do ta forcojnë partneritetin strategjik ShBA - Serbi. Për këtë marrëveshje ka reaguar opozita në Kosovë. Përfaqësuesit e PDK-së dhe të LDK-së kanë drejtuar kritika në adresë të qeverisë Kurti, duke theksuar se është duke cenuar partneritetin strategjik të Kosovës me ShBA-në

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Serbia kanë nënshkruar një marrëveshje për bashkëpunim strategjik në fushën e energjisë në Serbi.

Departamenti Amerikan i Shtetit tha në një njoftim se "kjo marrëveshje do t'i zgjerojë mundësitë për kompanitë amerikane për të investuar në sektorin e energjisë në Serbi, përfshirë promovimin e investimeve amerikane që do ta forcojnë partneritetin strategjik ShBA - Serbi".

Marrëveshja u nënshkrua të mërkurën nga nënsekretari i Shteteve të Bashkuara për Rritje Ekonomike, Energji dhe Mjedisi, Jose Fernandez, dhe ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, Marko Gjuriq.

Fernandez tha se "aftësia jonë për të punuar në energjinë e pastër, si dhe mundësia që kompanitë amerikane të investojnë në

teknologjitë nga ajo fushë në Serbi, është diçka që ne e vlerësojmë shumë". Ai shtoi se ShBA-ja është e lumtur që bashkëpunimi me Serbinë në fushën e energjisë së gjelbër do të vazhdojë. "Ndryshimi i klimës është sfida e kohës sonë. Por është, gjithashtu, një mundësi për të investuar në energjinë e së ardhmes dhe hapi i parë u hodh sot", tha Fernandez.

Gjuriq tha se marrëveshja do ta lehtësojë kalimin në energji të gjelbër në Serbi dhe do të ofrojë qasje më të mirë në energji të pastër. "Kjo marrëveshje do të rezultojë në furnizim më të besueshëm dhe afatgjatë. Nga kjo do të përfitojnë qytetarët dhe kompanitë energjetike serbe dhe amerikane", shtoi Gjuriq.

Shefi i diplomacisë serbe tha se nënshkrimi i marrëveshjes dërgon një mesazh të fortë për përkushtimin e Serbisë për përmirësimin e marrëdhënieve të përgjithshme me ShBA-në. "Vetë fjala 'strategjik' flet për faktin se tani jemi një hap më afër një

partneriteti strategjik dhe marrëdhënieve strategjike, të mira, cilësore dhe afatgjat me ShBA-në", përfundoi Gjuriq.

Gjuriq tha se në dy dekadat e ardhshme, Serbia do ta rrisë konsumin e saj të energjisë elektrike katërfish dhe se ka nevojë për partneritet me industrinë, kompanitë dhe vendet që kanë rritur kapacitetin e tyre prodhues në dekadat e kaluara.

Për këtë marrëveshje ka reaguar opozita në Kosovë, duke drejtuar kritika në adresë të qeverisë Kurti. Sekretarja e përgjithshme e PDK-së, Vlora Çitaku, ka thënë se Kosova po vazhdon e izoluar, e snaksionuar dhe e përjashtuar. Ajo i ka thënë Kurtit se Kosova është më e madhe dhe më e rëndësishme se egoja e tij. "Serbia dje e nënshkroi një marrëveshje me ShBA-në për investime strategjike në fushën e energjetikës, pas marrëveshjes me Gjermaninë për litium, dhe me Francën për avionët e avancuar ushtarakë. E Kosova? E izoluar, e snaksionuar, e përjashtuar. Kur

miqtë tanë, ata pa ndihmën e të cilëve nuk do të ishim as të lirë e as të pavarur, që të gjithë, na thonë që jemi në rrugë të gabuar, është koha me e pa veten në pasqyre. Nuk na ka faj kurrkush. Biden i keq, Trump i keq, Mogerini e keqe, Borelli i keq, Greneli i keq, Lajcak i keq, Merkel e keqe, Scholz i keq, Macroni i keq, Rama i keq. Krejt na kanë faj. A po Albin? Vetëm ti e ke mirë. Ti edhe kush? Kush janë aleatët e tu Albin? Se pa aleatë nuk mundet as Amerika. Albin Kurti, Kosova është ma e madhe dhe më e rëndësishme se egoja jote. Mashtrimit tënd po i vije fundi", ka shkruar Çitaku në "Facebook".

Ish-kryeministri Avdullah Hoti, aktualisht deputet i LDK-së, ka theksuar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nënshkruajnë marrëveshje me Serbinë për bashkëpunim strategjik shumëvjeçar në fushën e energjisë, fushë që është bërë çështje e sigurisë kombëtare. Sipas tij, Serbia, gjithashtu, hyn në marrëveshje me Gjermaninë për shfrytëzimin e litiumit, si dhe me Francën për furnizim me avionët ushtarakë. "Në anën tjetër, Kosova është nën masa financiare nga BE-ja për më shumë se një vit, të cilat i kanë bllokuar reformat ekonomike e institucionale të Kosovës drejt BE-së, siç përcaktohet me Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit Kosovë-BE të vitit 2016. Së fundmi, Kosova po kërcënohet nga vendet kryesore të BE-së me përjashtim nga Procesi i Berlinit, i

cili është mekanizmi formal i përgatitjes së Ballkanit Perëndimor për integrim evropian. Po ashtu, kanë ardhur paralajmërime nga ShBA-ja se mund të ndërpritet bashkëpunimi me Policinë e Kosovës", ka shkruar Hoti në "Facebook".

Ai ka parashtruar edhe disa pyetje për Kurtin dhe Osmanin. "Çdo qytetar sot duhet të pyes Kurtin dhe Osmanin: Përse nuk u zbatua Marrëveshja e Uashingtonit të 4 shtatorit 2020, e cila pritej të zgjidhte problemin e furnizimit me energji në Kosovë? Përse u anulua projekti i gazit? Përse nënçmohej partneriteti me ShBA për gaz duke iu referuar 'aleanca e gypave'? Përse nuk u nis me amerikanët hekurudha për Durrës? Përse nuk u zbatua 'Marrëveshja Kosovë - ShBA e 31 dhjetorit 2020 për nxitjen e investimeve', e cila pritej të mobilizonte investimet amerikane në Kosovë? Kujt i përshtatet moszbatimi i Marrëveshjes së Uashingtonit nga ana e Kosovës? Cenimi i partneritetit strategjik të Kosovës me ShBA-në duhet të jetë alarm shqetësues për secilin qytetar që e do Kosovën në BE dhe NATO, e në partneritet të ngushtë me ShBA-në. Më 9 shkurt 2025 qytetarët vendosin për qeverisjen e ardhshme. Kjo është dita kur duhet të marrë fund kjo qeverisje e dëmshme për Kosovën, si dhe për aleatët e Kosovës që duan ta shohin popullin e Kosovës pjesë të familjes së popujve në BE dhe NATO", ka deklaruar Hoti.

'Izolimi i Kosovës dhe autonomia e veriut', PSD-ja ilustron 'Rrugëtimin e Kurtit' me një aksion simbolik mbi Urën e Ibrit

MITROVICË, 19 SHTATOR - Partia Socialdemokrate (PSD) përmes një aksioni simbolik ka ilustruar "Rrugëtimin e Kurtit" në një pankartë të vendosur mbi Urën e Ibrit në Mitrovicë. Në këtë pankartë aktivistët e PSD-së kanë ilustruar gjithë veprimtarinë dhe vendimet e qeverisë në udhëheqjen e kryeministrit Albin Kurti për veriun e Kosovës. Sipas pankartës, në fund të këtij "rrugëtimi" aktivistët kanë ndarë dy rrugë simbolike, duke i quajtur "Izolimi i Kosovës" dhe "Autonomia e veriut".

Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, para gazetarëve ka thënë se Ura e Ibrit është kufiri politik i Albin Kurtit. "Të gjithë e dini që ura prapa meje ka qenë simbol i ndarjes së Mitrovicës, përkatësisht në dy komuna të veriut dhe të jugut. Pas marrjes së pushtetit nga qeveria Kurti, kjo ka marrë të paktën edhe tri domethënie të reja. E para ky është kufiri politik i Kurtit, sepse të gjithë ata që e kanë menduar Kurtin ndoshta edhe si superman, i cili dita-ditës do të bëjë mrekulli me çështjen e sovranitetit të Kosovës, këtu ka treguar që është brenda konceptit 'ngrehe mos e këput', ka thënë Molliqaj. Ai tutje tha: "E dyta, këtu është kufiri i sovranitetit të Kosovës. Nuk mund të ketë sovranitet të pjesshëm, nuk mund të thuash



'e mbylli postën e Serbisë, por vendimin për ta hapur një urë nuk mund ta bëj'. Ajo që është më e rëndësishmja dhe për të cilën ne kemi ardhur këtu, ky është momenti që ka shpjeguar shumë qartë dhe vizualisht

'Rrugëtimin e Kurtit'. Këtë 'rrugëtim' që ju të gjithë e dini, PSD-ja e ka kundërshtuar në secilin prej vendimeve të tij". Molliqaj tutje shtoi se janë kundër çdo vendimi të

qeverisë Kurti. "Ne jemi kundër çdo vendimi të tillë që qeveria e ka marrë, dhe absolutisht jemi kundër hapjes së urës në këtë rrugë. Pra nuk kemi ardhur këtu për të thënë se ura duhet të hapet, por kemi

ardhur këtu për të treguar se ura ia ka çel sytë secilit për të kuptuar që ky 'rrugëtim i Kurtit' me këtë qasje të Kurtit çon ja në autonomi, ja në izolim", ka thënë kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj.

Von der Leyen takon liderët e Ballkanit Perëndimor



Bruksel, 19 shtator - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, është takuar të enjten në Bruksel me liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor për një drekë pune. Në këtë takim morën pjesë kryeministri i Kosovës, i Shqipërisë, i Maqedonisë së Veriut, i Malit të Zi dhe i Bosnjë-Hercegovinës,

ndërsa Serbia u përfaqësua me presidentin e saj. Në një shkrim në "X" pas takimit, Von der Leyen tha se gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor e kanë vendin në Bashkim Evropian. "Sot i pritja liderët e gjashtë partnerëve nga Ballkani Perëndimor. Që të gjitha gjashtë vendet e kanë vendin në Evropë.

Pikërisht për këtë jemi duke punuar. Njëkohësisht, ne jemi duke i sjell ekonomitë dhe tregjet e tyre më afër tonave me Planin tonë të Rritjes prej 6 miliardë eurosh për rajonin", ka shkruar ajo. Sipas burimeve në Komisionin Evropian, takimi i Von der Leyen me liderët e Ballkanit ishte

informues lidhur me qëllimet dhe misionin që do të ketë KE-ja në pesë vjetët e ardhshëm, sa do të zgjasë mandati i saj i dytë në krye të këtij institucioni.

Von der Leyen ka caktuar kandidaten nga Sllovenia, Marta Kos, komisionare për Zgjerim, që do të thotë se ajo do të merret edhe me raportet me rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Von der Leyen me këtë takim dëshmoi se edhe në mandatin e ri do t'i kushtojë kujdes të veçantë këtij rajoni dhe në përgjithësi procesit të zgjerimit të BE-së.

Në takim u diskutua edhe për "agjendën e reformave dhe rritjes", të cilat tashmë i kanë dorëzuar në Komisionin Evropian të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit, si parakusht për t'i pranuar pagesat e para nga Plan i Rritjes për Ballkanin Perëndimor. Bosnjë-Hercegovina ka qenë e fundit që ka dorëzuar një dokument të tillë.

Von der Leyen personalisht ishte angazhuar për ta promovuar këtë plan, ndërsa atë e ka mbështetur edhe Parlamenti Evropian edhe

vendet anëtare në Këshillin e BE-së. Ky plan, që është një paketë prej 6 miliardë eurosh, konsiderohet plani më ambicioz financiar i BE-së për vendet e rajonit dhe ka për qëllim t'u ndihmojë atyre ta përshpejtojnë rritjen ekonomike, procesin e reformave dhe në këtë mënyrë të jenë më të gatshme për procesin e integritimit në BE.

Sipas një përlogaritje jozyrtare, Kosova do të mund të përfitojë mbi 880 milionë euro nga ky Plan i Rritjes. Për Kosovën dhe për Serbinë, përveç kriterëve të përgjithshme që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, kusht për të përfituar nga ky Plan i Rritjes është edhe angazhimi konstruktiv në procesin e normalizimit të raporteve mes tyre, që përfshin edhe zbatimin e të gjitha obligimeve nga procesi i dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë qëndrimit në Bruksel, përveç drekës së punës të organizuar nga presidentja e Komisionit Evropian, do të ketë edhe një diskutim në Qendrën e Politikave Evropiane (EPC).

Miratohet vendimi për dhënien e 51 pronave publike për 99 vjet në komunën e Drenasit



DRENAS, 19 SHTATOR - Është miratuar vendimi për dhënien e 51 pronave publike për 99 vjet të komunës së

Drenasit. Për këtë vendim, 17 vota kanë qenë për, 12 kundër dhe 1 abstenim, kurse nga lista paraprake janë

hequr prona e komunës së vjetër dhe e çerdhes. Të enjten në Kuvendin Komunal të Drenasit si pikë e rendit të ditës

ishte votimi për propozimvendimin për dhënien e pronave publike të kësaj komune për shfrytëzim afatgjatë.

Arrestohen katër persona të dyshuar për 'fajde' dhe 'organizim të skemave piramidale të bixhozit'

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, në bashkëpunim me Prokurorinë

Themelore Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, në vazhden e luftimit të dukurisë së fajdesë, pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore, sot ka realizuar operacion policor, me ç'rast ka zbatuar urdhërkontroll në tri lokacione në Prishtinë ndaj katër personave të dyshuar për veprat penale 'fajde' nga neni 331 i KPRK-së dhe 'organizimi i skemave piramidale ose bixhozit të paligjshëm' nga neni 294 i KPRK-së.

Të dyshuarit në këtë rast, përmes formave të ndryshme të kanosjes, në vazhdimësi kanë

detyruar viktimën që të veprojë kundër pasurisë së tij, duke përfutur kështu në formë të kundërligjshme shuma të ndryshme të parave si interes nga fajdeja, po ashtu të dyshuarit kanë ushtruar edhe veprimtarinë e bixhozit të kundërligjshëm.

Gjatë zbatimit të urdhërkontrollit janë sekuestruar dëshmi të ndryshme si: shuma të konsiderueshme të parave kesh, 5 automjete, telefona celularë, pajisje të ndryshme elektronike. Katër personave të dyshuar A. A., S. A., E. G. dhe A. G., pas intervistimit, me aktvendim të prokurorit nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, iu caktohet masa e ndalimit për 48 orë.



FSK-ja, e gatshme për garën "Cambrian Patrol 2024"



PRISHTINË, 19 SHTATOR - Në kuadër të përgatitjeve për pjesëmarrje në garën "Cambrian Patrol 2024", skuadra e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe një skuadër nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në koordinim me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar dhe me

qëllim vlerësimin e skuadrave pjesëmarrëse në garë, kanë realizuar ushtrimin fushor "Camprep24", ku skuadrat u testuan dhe kaluan sfidat e ngjashme që do të jenë gjatë realizimit të garës.

Skuadrat treguan disiplinë, motiv dhe përkushtim të lartë,

duke bërë më të mirën për t'i përfaqësuar vendet tona në garën më të madhe të ushtrive të botës siç është gara "Cambrian Patrol", që realizohet çdo vit në Mbretërinë e Bashkuar dhe me pjesëmarrjen e një numri të madh nga të gjitha vendet e botës.

Sekuestrohen katër armë zjarri në Breznicë të Obiliqit

OBILIQ, 19 SHTATOR - Pas marrjes së informatave në rrugë operative, Njësitë e Stacionit Policor të Obiliqit, të mbështetur nga Njësi të Reagimit të Shpejtë, me autorizim të Prokurorit të Shtetit, në fshatin Breznicë të Obiliqit kanë ushtruar kontroll në shtëpinë dhe objektet përcjellëse (pronë e të dyshuarit), ku kanë gjetur dhe sekuestruar një armë të gjatë

M-48, dy armë ajrore dhe një armë artizanale etj.

Personi i dyshuar E. K., mashkull, 61 vjeç, me vendim të prokurorit është dërguar në mbajtje për 48 orë. Ndaj tij janë kryer procedurat e nevojshme policore në koordinim me prokurorin e shtetit dhe është hapur rast për veprën "Mbajtje ne pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve".



Mbahet takimi i grupit punues për ndryshimin e statutit të komunës së Rahovecit

RAHOVEC, 19 SHTATOR - Të enjten u mbajt takimi i grupit punues për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të komunës së Rahovecit, i

kryesuar nga kryetari i komunës, Smajl Latifi. Në këtë takim u diskutua për ndryshimet që do t'i japin Statutit të komunës një përmbajtje më të

përshtatshme me rrethanat aktuale, të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Përfaqësuesit e Kuvendit dhe ekzekutivit shprehën mbështetjen e tyre për procesin dhe angazhimin për të siguruar që statuti i ri të jetë gjithëpërfshirës.



Dialogu | Miroslav Lajçak, shfaqja e njëanshmërisë në favor të Serbisë, sfidat për Kosovën dhe nevoja për koordinim të ngushtë me ShBA-në



Shkruan: Prof. dr. Fejzulla BERISHA

Miroslav Lajçak, si përfaqësues i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, është një personalitet që ka nxitur shumë polemika, veçanërisht për rolin e tij dhe qasjen në këtë proces të ndjeshëm. Në veçanti, në Kosovë ka një perceptim të gjerë që Lajçaku ka dëmtuar këtë dialog, duke favorizuar Serbinë në disa aspekte të rëndësishme të negociatave dhe duke krijuar një situatë të padrejtë për Kosovën. Këtu do të analizojmë me gjerësi se pse Lajçaku është parë si një "dëmtues kryesor" i dialogut dhe se cilat janë pasojat e kësaj qasje për Kosovën.

Qasja e Lajçakut dhe favorizimi i Serbisë: Një nga kritikët kryesorë që është ngritur kundër Miroslav Lajçakut lidhet me perceptimin se ai ka favorizuar Serbinë në mënyrë të dukshme gjatë dialogut. Kjo kritikë është përforcuar nga disa deklaratatë të tij, që në sytë e shumë njerëzve në Kosovë kanë treguar një prirje për të kërkuar kompromise të dhimbshme nga Kosova, ndërsa Serbia shpesh ka dalë e përfituar ose ka vazhduar të mbajë pozicionin e saj refuzues pa pasojat e ndjeshme.

Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe: Çështja më e ndjeshme dhe e debatueshme është ajo e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Krijimi i një asociacioni të tillë, që do të përfshijë komuna me shumicë serbe në Kosovë, është një pjesë kyçe e marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013. Megjithatë, ky asociacion, ashtu si është përkufizuar, ka ngjallur frikë se do të krijojë një strukturë që do të rrezikonte funksionalitetin dhe sovranitetin e Kosovës. Lajçaku dhe Bashkimi Evropian kanë këmbëngulur që ky asociacion të formohet, shpesh duke anashkaluar shqetësimet që ka ngritur Kosova në lidhje me ndikimin që mund të ketë kjo strukturë. Kritikët argumentojnë se Lajçaku nuk ka marrë parasysh mjaftueshëm shqetësimet e brendshme të Kosovës për mënyrën se si ky asociacion mund të dobësojë funksionimin

institucional të vendit. Për më tepër, vendosmëria për të vazhduar me këtë çështje pa një diskutim të hapur dhe të drejtë për kompetencat e këtij asociacioni është parë si favorizim ndaj Serbisë, e cila ka këmbëngulur në krijimin e tij.

Njohja e Pavarësisë së Kosovës: Një tjetër aspekt kyç i favorizimit të perceptuar të Serbisë nga Lajçaku është qasja e tij ndaj njohjes së Kosovës si shtet i pavarur. Përderisa Serbia refuzon kategorikisht ta njohë Kosovën, dialogu ka vazhduar për vite pa bërë përparime të dukshme drejt këtij qëllimi. Kritikët argumentojnë se Lajçaku nuk ka ushtruar presion të mjaftueshëm mbi Serbinë për ta njohur pavarësinë e Kosovës, duke lënë të kuptohet se dialogu mund të vazhdojë pa një njohje të qartë të realitetit të shtetësisë së Kosovës. Ky është një problem i madh për Kosovën, e cila kërkon që dialogu të përqendrohet në njohjen e ndërsjellë dhe integrimin e plotë në organizatat ndërkombëtare, përfshirë Kombet e Bashkuara. Mungesa e një presioni të qartë ndaj Serbisë për ta zgjidhur këtë çështje thelbësore ka krijuar një situatë ku dialogu po përqendrohet më shumë në çështje teknike ose të brendshme, duke i lënë anash kërkesat legjitime të Kosovës për sovranitet dhe njohje ndërkombëtare.

Tensionet në veri të Kosovës dhe paqëndrueshmëria: Një nga pasojat më të dukshme të qasjes së Lajçakut dhe dialogut të favorizuar për Serbinë është rritja e tensioneve në veri të Kosovës, ku shumica e popullsisë janë serbë. Përpjekjet e qeverisë së Kosovës për të integruar këtë pjesë të vendit dhe për të vendosur kontrollin e plotë të saj janë përballur me rezistencë të fortë nga serbët lokalë dhe nga Beogradi, që vazhdon të luajë një rol aktiv në mbështetjen e tyre. Incidentet e fundit në veri të Kosovës, përfshirë përplasjet mes policisë dhe serbëve lokalë, janë pasojë e drejtpërdrejtë e mosmarrëveshjeve të vazhdueshme mbi kontrollin dhe sovranitetin në këtë rajon. Pavarësisht presioneve ndërkombëtare, Serbia vazhdon të mbajë ndikim të fortë në këto komuna, duke përdorur verium si një mjet për të mbajtur Kosovën në një pozitë të dobët. Ky është një tregues se dialogu nuk po arrin të zgjidhë çështjet themelore të sovranitetit të Kosovës dhe stabilitetit në veri.

Dinamika gjeopolitike dhe presioni ndërkombëtar: Një faktor tjetër që ka ndikuar në këtë

dialog është roli i gjeopolitikës në rajon. Serbia ka pozicionuar veten si një vend që balancon mes perëndimit dhe fuqive lindore, si Rusia dhe Kina. Kjo e ka bërë të vështirë për BE-në, përfshirë edhe Lajçakun, të ushtrojë presion të fortë ndaj Beogradit për të bërë lëshime domethënëse. Serbia ka përfituar nga një pozicion i favorshëm ndërkombëtar, duke marrë mbështetje ekonomike dhe politike nga perëndimi pa bërë përparime reale në normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën. Në këtë kontekst, Lajçaku dhe BE-ja kanë qenë të kujdesshëm në trajtimin e Serbisë, duke mos dashur të prishin marrëdhëniet me një vend që konsiderohet kyç për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor. Kjo qasje ka thelluar perceptimin se Serbia ka më shumë përfitime nga dialogu, ndërsa Kosova po përballlet me një presion më të madh për të bërë lëshime.

Rrugëdalja nga qorrsoakaku: Çfarë duhet ndryshuar? Nëse dialogu Kosovë-Serbi vazhdon në të njëjtën rrugë që ka ndjekur deri më tani, me Lajçakun në krye dhe me favorizimin e vazhdueshëm të Serbisë, ekziston rreziku që Kosova të përballlet me pasojat të rënda afatgjata. Për të shmangur këtë skenar, disa ndryshime strategjike janë të nevojshme.

Presion ndërkombëtar mbi Serbinë: Një nga ndryshimet më të rëndësishme që duhet të ndodhë është rritja e presionit ndërkombëtar mbi Serbinë për të bërë lëshime të vërteta në procesin e dialogut. Njohja e Kosovës duhet të jetë një nga pikat kyçe në tryezën e negociatave, dhe Serbia duhet të përballlet me pasojat konkrete nëse vazhdon të refuzojë këtë njohje.

Mbështetje për sovranitetin e Kosovës: Bashkimi Evropian dhe ndërmjetësit e dialogut duhet të respektojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës.

Çështje si Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe duhet të trajtohen në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe pa kompromentuar funksionalitetin shtetëror të vendit. Krijimi i një strukture që sfidon sovranitetin e Kosovës nuk duhet të jetë pjesë e zgjidhjes së dialogut.

Moskordinimi i politikës së Kosovës me ShBA-në, që është aleati kryesor dhe mbështetësi më i fuqishëm i shtetësisë dhe sovranitetit të Kosovës, krijon një situatë të ndërlikuar që u shkon përshtati interesave të Serbisë dhe përfaqësuesit të BE-së, Miroslav Lajçak. Kur Kosova dështoi të harmonizojë politikën e saj me ato të partnerëve strategjikë ndërkombëtarë, në veçanti me ShBA-në, kjo dobëson fuqinë e saj negociuese dhe pozitën e saj ndërkombëtare. ShBA-ja ka qenë për shumë vite shtylla kryesore për përparimin e Kosovës në drejtim të njohjes ndërkombëtare, forcimit të institucioneve demokratike dhe përpjekjeve për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Çdo mospërputhje ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së mund të shkaktojë një humbje të mbështetjes së përhershme diplomatike dhe të ushtrojë presion mbi Kosovën për të bërë lëshime në bisedimet me Serbinë. Nga ana tjetër, Miroslav Lajçak, i cili përfaqëson Bashkimin Evropian në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, përfiton nga këto përçarje. Pozita e tij është që të ruajë një balancë në marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por kjo shpesh është interpretuar si një qasje që favorizon Serbinë, veçanërisht kur BE-ja ka dështuar të tregojë një qëndrim të qartë për njohjen e Kosovës. Ky moskoordinim i politikave me ShBA-në vetëm sa e forcon ndikimin e Lajçakut dhe BE-së si ndërmjetës neutralë, duke dobësuar gjithashtu rolin e ShBA-së në proces. Serbia, ndërkohë, përfiton nga ky boshllëk në

bashkëpunimin ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së. Duke shfrytëzuar çdo distancë apo çarje në marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe aleatëve të saj perëndimorë, Serbia është në gjendje të avancojë interesat e saj, veçanërisht në arenën diplomatike, duke lobuar kundër njohjes së Kosovës dhe duke fituar më shumë mbështetje nga vende që nuk e kanë njohur ende Kosovën. Moskordinimi i politikës me ShBA-në rrezikon gjithashtu integrimin e Kosovës në institucionet evropiane dhe euroatlantike, si dhe dobëson perspektivën e saj për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, përfshirë OKB-në. Për Kosovën është thelbësore të mbajë një linjë të qëndrueshme dhe të sinkronizuar me ShBA-në, në mënyrë që të ruajë stabilitetin e saj diplomatik dhe të vazhdojë të jetë një partner i besuar për fuqitë perëndimore.

Pjesëmarrja e ShBA-së në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka qenë dhe mbetet faktor kyç në përpjekjet për të zgjidhur konflikte dhe për të arritur një marrëveshje të qëndrueshme. Në të ardhmen, është e mundur dhe duhet që ShBA të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm për disa arsye: Interesat Strategjike: ShBA ka interesa strategjike në stabilitetin e Ballkanit, dhe një marrëveshje e qëndrueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është e rëndësishme për stabilitetin e rajonit.

Mbështetje ndërkombëtare: ShBA mund të përdorë ndikimin e saj për të siguruar mbështetje ndërkombëtare për një marrëveshje dhe për të ndihmuar në menaxhimin e proceseve të implementimit të saj.

Diplomacia dhe ndihma ekonomike: ShBA mund të ofrojë asistencë ekonomike dhe diplomatike për të ndihmuar në zbatimin e marrëveshjes dhe për të siguruar që palët të përmbushin angazhimet e tyre.

Përpjekjet për pajtimin: ShBA ka ndihmuar në promovimin e dialogut dhe mund të vazhdojë të luajë një rol aktiv në ndihmën e palëve për të gjetur zgjidhje dhe për të ndihmuar në mosmarrëveshjeve të mbetura.

Ndikimi politik: ShBA ka një ndikim të konsiderueshëm në politikën ndërkombëtare dhe mund të përdorë këtë ndikim për të promovuar një zgjidhje të drejtë dhe të qëndrueshme për të dy palët. Roli i ShBA-së në të ardhmen do të varet nga zhvillimet politike dhe diplomatike, si dhe nga angazhimet e tjera të ShBA-së në nivel global.



Gërxhaliu: Qytetarët dhe bizneset e Ballkanit Perëndimor e dëshirojnë integrimin dhe bashkëpunimin rajonal, por politika e pengon këtë proces

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka thënë se qytetarët dhe bizneset e Ballkanit Perëndimor e dëshirojnë integrimin dhe bashkëpunimin rajonal, por politika është duke e penguar këtë proces. Ai ka thënë se integrimi në familjen evropiane nuk ka alternativë dhe dialogu i bazuar në barazi dhe partneritet me shtetet evropiane duhet të jetë mekanizëm që i përshpejton këto procese për integrimin e Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. "Raporti i Barometrit Ballkanik 2024 ka sjell në pah perceptimet e 6 000 qytetarëve dhe 1 200 liderëve të biznesit në Ballkanin Perëndimor, duke theksuar një dëshirë të fortë për bashkëpunim rajonal dhe integrim në BE, pavarësisht prej sfidave që politika shpesh u sjell këtyre proceseve. Ja disa nga gjetjet kryesore:

Bashkëpunimi rajonal: Në vitin 2024 mbështetja për bashkëpunimin rajonal ka arritur



një nivel historik prej 82 %, një rritje nga 76 % sa ishte në vitin 2023. Qytetarët po dëshmojnë gjithnjë e më shumë rëndësinë e unitetit për t'i kapërcyer ndasitë dhe për të ndërtuar një të ardhme më të sigurt për rajonin. Integrimi në BE: Edhe pse mbështetja për anëtarësimin në

BE ka rënë pak në 2024-n (54 %). Qytetarët ende besojnë se integrimi do të sjellë përfitime ekonomike. Ky qëndrim është më i ulët krahasuar me vitin 2023, kur 59 % e qytetarëve e mbështetën këtë ide. Shqetësimet ekonomike: Inflacioni është bërë shqetësimi

kryesor më 2024, me 64 % të të anketuarve që ndiejnë ndikimin e rritjes së çmimeve, ndërsa papunësia bie nga fokusi i vitit 2023. Ndërsa më 2023 shqetësimet për papunësinë ishin më të larta, fokusi tani është zhvendosur te korrupsioni dhe rritja e çmimeve, ka treguar disa nga gjetjet Gërxhaliu, për të treguar edhe për rënien e optimizmit ekonomik. "Vetëm 37 % e qytetarëve më 2024 presin një përmirësim ekonomik gjatë vitit të ardhshëm, krahasuar me 42 % më 2023. Ky ndryshim tregon një shqetësim në rritje për stagnimin ekonomik dhe sfidat e vazhdueshme. Raporti i këtij viti na tregon një tendencë të qartë: qytetarët dhe bizneset e Ballkanit Perëndimor janë të etur për një bashkëpunim dhe integrim më të madh, por janë të vetëdijshëm për pengesat që sjell politika dhe sfidat ekonomike. Tani është koha për t'i dëgjuar dhe për të vepruar në favor të këtij uniteti të dëshiruar!", ka thënë ai. Gërxhaliu ka theksuar se anti-

evropeizmi në Ballkanin Perëndimor, anti-amerikanizmi në Evropë dhe dedollarizimi në vendet e BRICS-it janë më tepër të prira nga politika sesa nga vullneti i qytetarëve dhe bizneseve. "Në Ballkanin Perëndimor po promovohen politika majtiste dhe nacionaliste të cilat me çdo kusht luftojnë për pushtet, por raporti në fjalë dëshmon se qytetarët dhe komuniteti i biznesit mendon dhe vepron ndryshe. Politika e qeverive të Ballkanit Perëndimor duhet të jenë të orientuara në barazi politike, zhvillim ekonomik, stabilitet social, integritet, digjitalizim, edukim, diplomaci e jo në destruktivitet politik që Ballkanin Perëndimor e kanë shndërruar në shtete për të ikur dhe jo në shtete të perspektivës dhe zhvillimit. Nuk jetohet nga prodhimi i historisë dhe nacionalizmit nga e kaluara, por nga perspektiva dhe besimi në të ardhmen", ka theksuar njohësi i ekonomisë, Safet Gërxhaliu.

Mbahet konferenca e Anketës me Tregues të Shumëfishtë - 'MICS'

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Është mbajtur konferenca e Anketës me Tregues të Shumëfishtë (MICS), ngjarje në të cilën mori pjesë edhe kryeministri Albin Kurti. Të pranishëm ishin edhe Arnhild Spence, koordinatore rezidente e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin në Kosovë, Avni Kastrati, ushtrues i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Veronika Vashchenko, shefe e UNICEF-it në Kosovë, përfaqësues të korit diplomatik e përfaqësues të kabinetit qeveritar.

Anketa e MICS është një instrument i fuqishëm që ofron të dhëna mbi mirëqenien e fëmijëve dhe familjeve në vendin tonë dhe të cilat masin treguesit kyç që u mundësojnë shteteve të gjenerojnë të dhëna për përdorim në politika, programe, dhe planet e zhvillimit kombëtar. Kryeministri Kurti gjatë fjalës së tij u shpreh se qasja në të dhëna të besueshme dhe cilësore

është thelbësore për të marrë vendime të informuara dhe për të bërë investime strategjike. "Një nga pikat më të forta të MICS është grupi gjithëpërfshirës prej 120 treguesish që i ofron. Këta tregues na mundësojnë të përzgjedhim ata më të rëndësishmit për ta mbikëqyrur progresin e strategjive tona kombëtare, duke përfshirë përmirësimet në mirëqenien e fëmijëve, shëndetin e nënave dhe rezultatet në arsim", ka deklaruar kryeministri.

Ai u shpreh se ndër vite MICS ka qenë një shtyllë kryesore për formësimin e politikave të bazuara në fakte, duke mbështetur objektivat afatgjatë për zhvillimin e Kosovës, nga Plani Kombëtar për Zhvillim deri te Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve dhe planet sektoriale. Para të pranishmëve, kryeministri përmendi edhe dy raundet e MICS në Kosovë, të zhvilluara në vitet 2014 dhe 2020, të cilat kanë përfshirë një



mostër të veçantë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Këto të dhëna, përveç se kanë sjellë në vëmendje nevojat e komuniteteve në Kosovë, kanë ndihmuar edhe në krijimin e strategjive të synuara, siç është Strategjia dhe

Plani i Veprimit për Romët dhe Egjiptianët.

Në anën tjetër, këto raunde kanë ndihmuar ASK-në t'i forcojë kapacitetet e saj në mbledhjen dhe analizën e të dhënave, duke mbështetur zhvillimin e politikave të

bazuara në dëshmi të besueshme. "Falë MICS, të dhënat e Kosovës mund të krahasohen me ato të vendeve të tjera të rajonit dhe më gjerë. Për më tepër, MICS na ofron një mori informacioni që mbështet monitorimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, pra të SDG-ve apo 'Sustainable Development Goals', ka theksuar Kurti, duke theksuar se MICS na vendos në hartën globale të të dhënave, duke na ofruar tregues të krahasueshëm ndërkombëtarisht dhe duke na lejuar të bëjmë një vlerësim objektiv të përparimit tonë në fusha të ndryshme. Programi global i MICS-it është krijuar nga UNICEF në vitet 1990 si pjesë e programit ndërkombëtar të anketimit të ekonomive familjare për t'i mbështetur vendet të grumbullojnë të dhëna që janë ndërkombëtarisht të krahasueshme për një numër të madh treguesish mbi gjendjen e femrave dhe fëmijëve.

Projektligji për mbrojtjen e konsumatorit dhe ai për Kripto-asetet procedohen për në seancë plenare

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, kryesuar nga Ferat Shala, kryetar komisioni, ka mbajtur të enjten mbledhjen e radhës, duke miratuar unanimisht raportin e punës së komisionit për sesionin pranveror 2024. Në këtë

mbledhje anëtarët e komisionit me shumicë votash, miratuan raportin me rekomandime për lexim të dytë për Projektligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit si dhe Raportin me rekomandime për lexim të dytë për Projektligjin për Kripto-asetet. Si rrjedhojë, të

dy raportet do të procedohen tutje për shqyrtim në seancë plenare. Po ashtu, anëtarët e komisionit votuan pro rifillimit të rishpalljes së konkursit për zgjedhjen e "kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e

Ujit - ARRU". Po ashtu, u votua pro pjesëmarrjes së të gjithë anëtarëve të komisionit në formimin e panelit për zhvillimin e procesit të intervistimit për zgjedhjen "drejtor të Bordit të NP KOSTT- tri pozita". Më tutje, anëtarët e komisionit shqyrtuan çështje të tjera, të



ndryshme, që bien sipër fushëveprimtarisë së tyre.

Persët: Perandoria e të Mëdhenjve



Rreth vitit 1943, Robert Grejvs shkroi një poezi. Në të, ai hodhi një vështrim të zakonshëm mbi botën e lashtësisë, dhe zgjodhi si temë atë të luftës dhe të propagandës. Ai u përqendrua në Betejën e Maratonës, të zhvilluar në vitin 499 Para Krishtit, midis ushtrisë së Athinës dhe asaj të perandorisë perse.

I cilësuar si një triumf madhështor për athinasit, Maratona u mitizua shumë shpejt në mbarëbotën greqishtfolëse. Kur persët u zbrapsën nga toka greke, lindi legjenda e luftës heroike për liri dhe kundër despotizmit. Por kjo nuk është e gjitha. Sipas kësaj mënyre të leximit të historisë, në Maratonë lindi edhe Evropa.

Por kështu edhe perandoria britanike. Kjo është arsyeja pse në 1846, Xhon Stuart Mill pretendonte se “edhe si një ngjarje në historinë angleze”, Beteja e Maratonës ishte “më e rëndësishme sesa Beteja e Hastings”. Robert Grejvs e vuri në pikëpyetje atë qasje, dhe preferoi t’i lexonte pasojat e Betejës së Maratonës, si triumfin përfundimtar të një fushate propagande të suksesshme dhe jetëgjatë nga ana e athinasve.

Poema që shkroi Grejvs në vitin 1943 – Versioni Persian – buron nga këndvështrimi i vetë “persëve mbi të vërtetën”. Për ta, thekson ai, Maratona ishte pak më shumë se sa një “përleshje e parëndësishme” në skajet perëndimore të perandorisë së tyre, dhe sigurisht jo “përpjekja madhështore për të pushtuar Greqinë”, siç ishte përshkruar dhe mitizuar nga athinasit.

Nëse i hidhni një sy një hartë të Evropës Juglindore, Afrikës Veriore dhe Azisë Perëndimore në fillim të shekullit V Para Krishtit, kur u zhvillua beteja e Maratonës, është e vështirë të mos arrihet në përfundimin se Grejvs kishte njëfarë të drejte.

Midis ngjitjes në fron të Kirit të Madh në mesin e shekullit VI Para Krishtit, dhe vdekjes së pasardhësit të tij Darit III 2 shekuj më vonë, persët (me dinastinë e frikshme Akemenide në krye të tyre) udhëhoqën perandorinë më të madhe që kishte parë bota deri në atë kohë.

Pakistani, Irani, Iraku, Turqia dhe Greqia. Kjo ishte një perandori e ndërtuar mbi një infrastrukturë të përparuar, me një shkallë tolerance ndaj kulturave dhe feve të ndryshme, dhe kur kërkohet, edhe me një fuqi shkatërruese.

Duke pasur parasysh fuqinë e jashtëzakonshme që patën për 200 vjet, pse duhet të jetë e habitshme që Grejvs arriti në përfundimin se persët mund t’i kenë konsideruar luftërat me grekët si ngjarje periferike për ta? Megjithatë, Grejvs po “notonte” kundër rrymës. Gjatë Iluminizmit dy shekuj më parë, intelektualët kishin filluar të teorizonin se pse Perëndimi ishte bërë kaq dominues në rendin botëror, dhe pse kishte qenë kaq e suksesshme në përhapjen e qytetërimit të të bardhëve.

Ata dolën me një teori radikale: Epërsia evropiane nuk erdhi nga Krishterimi, siç ishte menduar më parë, por nga një traditë kulturore që filloi në Greqinë e lashtë. Grekët, pretendonin ata, shpikën lirinë dhe racionalitetin, dhe Roma më

pas i përhapi këto dhurata të çmuara në të gjithë Evropën nëpërmjet një serie pushtimesh perandorake civilizuese.

Kulturat e tjera në skajet e Greqisë dhe Romës ishin barbare. Dhe barbarët më të këqij dhe më kërcënues ishin persët, që synonin të arrinin dominim e botës. Që nga epoka e Luftërave Greko-Persiane, persët kanë qenë viktimat e një fushate shpifësh, gjatë të cilës ata janë etiketuar si tiranë shtypës të botës së lirë.

Kjo ka qenë shumë e dëmshme për studimin e historisë së Persisë së lashtë, dhe një problem i përkeqësuar nga fakti se persët nuk e shkruan kurrë historinë narrative ashtu siç bënë grekët. Përkundrazi, për të transmetuar të kaluarën e tyre, ata u mbështetën në tregimin gojor, poezitë dhe këngët.

Të shpëtuar nga tirania

Por çfarë mund të bëhet? Si mund t’i çlirojnë historianët persianët nga tirania e traditës klasike? Si mund ta lidhim ngritjen dhe rënien e perandorisë së tyre të jashtëzakonshme, nga një perspektivë që është neglizhuar për kaq shumë kohë nga historia? Përgjigja jepet nga një shumëllojshmëri burimesh vërtetë marramendëse, por mrekullisht ndriçuese. Ka mbishkrime mbretërore në gjuhën e vjetër perse; arkiva të pasura dokumentare kuneiforme të shkruara në baltë, të cilat na rrëfejnë për funksionimin e perandorisë, ekonominë dhe shërbimin e saj civil.

Ka një mori relievesh murale, dizajne në tekstil, punime prej ari dhe argjendi, dhe një trashëgimi e mrekullueshme arkeologjike, që tregojnë historinë e vërtetë mbi të kaluarën e Persisë. Falë shfaqjes së atyre thesareve historike, ne kemi qenë më në fund në gjendje t’u japim persëve një platformë, nga e cila ata ta tregojnë historinë e tyre.

Një mbret në ngritje

Kjo histori fillon në mesin e shekullit VI, me ngritjen e njërit prej sundimtarëve më të shquar të botës antike: Kirit II, ose “Kirit të Madh”. Kur u ngjit në fron në vitin 559 Para Krishtit, Persia ishte një mbretëri e vogël e vendosur në Iranin jugperëndimor. Vetëm një nga disa fise iraniane në vasalitetin e mbretërisë së Medëve.



Kur vdiq në vitin 530 para Krishtit, Persia ishte në rrugën e duhur drejt statusit të njësuperfuqie. Momenti kyç erdhi në vitin 550 Para Krishtit kur Kiri, i mbështetur nga një koalicion fisesh iraniano-jugore, marshoi drejt veriut për të sulmuar Medët dhe pushtoi kryeqytetin e tyre, Ekbatana.

Më pas, ai sulmoi mbretërinë e fuqishme të Lidias në Azinë e Vogël, duke pushtuar kryeqytetin e saj shumë të pasur, Sardis. Kjo fitore i hapi rrugën për të pushtuar qytete të tjera të rëndësishme përgjatë bregut të Detit Jonit.

Një moment tjetër historik në ngritjen e Persisë, ishte në vitin 540 Para Krishtit, kur Kiri nisi një sulm ndaj perandorisë neo-babilonase me qendër në Mesopotami, dhe hyri në qytetin jashtëzakonisht të pasur të Babilonisë. Mesa duket sundimtari pers nuk hasi asnjë rezistencë ushtarake ose politike dhe e ruajti statuskuonë, duke i lejuar zyrtarët babilonas të vazhdonin punën në postet e tyre qeveritare dhe fetare.

Pjesa më e madhe e njohurive tona mbi rënien e Babilonisë vjen nga Cilindri i Kirit, i shkruar me urdhër të Kirit, megjithëse nga një perspektivë babilonase. Si një pjesë e propagandës perandorake, Cilindri përpiqet që të legjitimojë pushtimin e Babilonisë nga Kiri duke përfaqësuar perëndinë Marduk. Pas pushtimit të Babilonisë, Kiri krijoi një perandori vërtet ndërkombëtare. Në Pasargadae të Iranit, mbreti ndërtoi një varr dhe një vend të mbjellë me një kopsht të ujitur nga një mori kanalesh uji.

Rezultati ishte një parajsë në mesin e shkretëtirës. Retorika mbretërore theksonte se të gjitha kombet e pushtuara të kësaj perandorie ishin të bashkuar në shërbim të Mbretit të Madh, dhe duhej t'u bindeshin ligjeve të tij. Thuhej se mbreti përkrahej nga Zoti i Madh Ahuramazda, i cili i dha monarkut dhuratën e mbretërimit për të stabilizuar rendin botëror, pasi trazirat dhe rebelimi ishin të lidhura me kaosin kozmik. Rebelimi kundër autoritetit të perandorisë shihej si një revoltë kundër autoritetit hyjnor, pasi Mbreti i Madh i shërbente vullnetit të Ahuramazdës në Tokë.

Ritet dhe ritualet

Kiri i Madh vdiq në luftë, duke luftuar kundër një fisi të Azisë Qendrore të quajtur Masagetae. Nuk ka asnjë dyshim se vdekja e mbretit, i dha një goditje të rëndë projektit perandorak persian, por nuk ishte e mjaftueshme për të shmangur zgjerimin e perandorisë.

Në fakt, pasardhësi i Kirit, Kambisi II, i shtoi perandorisë një vend tjetër të rëndësishëm: Egjiptin. Burimet greke e portretizojnë Kambisin si një despot të çmendur, që shtypte në mënyrë tiranike nënshtetasit e tij, dhe që poshtëronte traditat fetare të vendeve të pushtuara prej tij. Por dëshmitë arkeologjike në Egjipt, na japin një panoramë të ndryshme. Ato sugjerojnë sembreti pers zbatoi politikën e harmonisë fetare. Mbishkrimet nga Serapeum në Memfis (viti 524 Para Krishtit), konfirmojnë se ai nderoi vdekjen e një demi të

shenjtë me ritet dhe ritualet e duhura.

Qëndrimi liberal ndaj besimeve të ndryshme fetare dhe kulturore nga Kambisi, duket se ka qenë një tipar dalluese i sundimit pers. Megjithatë, Akamenidët mund të përdornin edhe forcën brutale për të arritur qëllimet e tyre, siç dëshmohet nga ngritja e njeriut që do të rivalizonte Kirin II si sundimtari më i suksesshëm nga të gjithë sundimtarët persë, dhe do të drejtonte perandorinë në kulmin e saj: Dari i Madh.

Dari u ngjiti një fron në vitin 522 Para Krishtit pasi rrezoi djalin e Kirit, Bardija, përmes një grushti shteti të përgjakshëm. Ai ishte i pamëshirshëm në shtypjen e revoltave që e tronditën perandorinë. Në pak më shumë se një vit, ai mposhti, kapi dhe ekzekutoi udhëheqësit rebelë. Për pjesën tjetër të mbretërimit të tij 36-vjeçar, ai nuk u kërcënua më nga asnjë kryengritje.

Tekstet bashkëkohore perse dëshmojnë për fuqinë e madhe të Darit dhe egërsinë e tij në mbrojtjen e perandorisë. Sipas një burimi, vetë Ahuramazda i kishte dhënë Darit "mbretërimin e kësaj Tokë të gjerë me shumë toka në të Persinë, Median dhe tokat e tjera të gjuhëve të tjera, të maleve dhe fushave, të kësaj ane të oqeanit dhe anës së largët të oqeanit, të kësaj ane të shkretëtirës dhe anës së largët të shkretëtirës".

Në një tekst tjetër, vetë mbreti paralajmëron ndëshkime të rënda që ai ishte gati të jepte për ata që guxonin të rebeloheshin. "Unë jam i egër në forcën e hakmarrjes sime, me të dyja duart dhe këmbët" – thuhet të ketë deklaruar ai. Megjithatë, reputacioni i

frikshëm i Darit nuk u ndërtua vetëm mbi fuqinë e egër ushtarake.

Ai u angazhua për zbatimin e projekteve të ndërtimit dhe të inxhinierisë në mbarë perandorinë. Në Egjipt ai ndërtoi një kanal midis Nilit dhe Detit të Kuq. Në zemrën e Iranit ai filloi një program të madh ndërtimi në Persepolis, që do të bëhej kryeqyteti ceremonial i perandorisë së tij.

Qytetit të Suzës (Irani Perëndimor) iu dha një jetë e re kur u bë kryeqyteti administrativ i perandorisë. Drejtimi i një perandorie prej 5.2 milionë km² paraqiste një sfidë të madhe logjistike, madje edhe për një sundimtar aq të aftë sa Dari.

Prandaj, ai i ndau territoret e perandorisë në satrapi (provinca administrative, dhe u dha poste të larta një grupi të vogël njerëzish, të nxjerrë ekskluzivisht nga nivelet më të larta të aristokracisë persiane. Këta satrapë, u përpoqën të nxisnin ndërveprime të shëndetshme me elitat lokale.

Drejtimi i qetë i perandorisë, mbështetej në aftësinë e tyre për të siguruar pagimin e taksave nga çdo rajon, dhe e arritën këtë në pjesën më të madhe të perandorisë. Në fakt, sistemi i satrapisë, është një nga arsyet kryesore pse persët ishin në gjendje të kontrollonin një perandori kaq të madhe për aq shumë kohë.


Një faktor tjetër që i dha Perandorisë Perse një avantazh shumë të madh konkurrues ishte cilësia e infrastrukturës së saj. Rrugët e klasit të parë, lidhnin qendrat kryesore me bërthamën perandorake. Ato mateshin në

intervale prej 6 km (të njohura si parasange), ndërsa stacionet rrugore ngriheshin çdo 27 km, për të mundësuar ndërrimin e shpejtë të kuajve të freskët, për çdo lajmëtar perandorak që transportonte dokumente zyrtare. Herodoti vlerësonte se distanca nga Suza në Sardë në Anadollin Perëndimor (450 parasange – ose 2735 km) mund të përshkohej në vetëm 90 ditë. Gjerësia e madhe e perandorisë së Darit pasqyrohet gjithashtu në artin akamenid. Kjo ishte në thelb një përzierje eklektike e stileve dhe motiveve të nxjerra nga pjesë të ndryshme të perandorisë, por të shkruara së bashku për të prodhuar një pamje të veçantë dhe harmonike që ishte dukshëm persiane.

Motivet egjiptiane dhe asiriane (si disqet diellore dhe xhindët me krahë), u shkrinë së bashku për të pasqyruar në formë materiale diversitetin dhe unitetin e perandorisë. Në një farë mënyre, arti akamenid ishte gjithmonë një art mbretëror, pasi motivet e krijuara për lavdërimin e mbretit, gjenden vazhdimisht në pothuajse të gjitha artefaktet materiale perse, duke filluar nga skulpturat e gdhendura në shkëmb – si ato të gjetura në Bisitun apo tek varret mbretërore në Naksh-e Rostam dhe Persepolis – deri tek gdhendjet e vogla të gjetura tek gurët e çmuar.

Pretendime të ekzagjeruara

Për të gjitha arritjet e tij si luftëtar dhe administrator, Dari i Madh mbahet mend, të paktën në Perëndim, si despot, planet pushtuese të të cilit për Greqinë,





morën fund në një mënyrë të përgjakshme në Betejën e Maratonës. Ndërsa Dari mund të ketë pasur ambicie për ta përfshirë Greqinë në perandorinë e tij, tregimi i Herodotit mbi tensionet

greko-persiane e ekzagjeron shumë përgjigjen persiane ndaj rezistencës greke.

Dari vdiq në vitin 486 Para Krishtit, dhe detyra e zgjerimit të perandorisë i kaloi djalit të tij

Kserksit. Kserksi tregohet i pamëshirshëm kur e donte puna, si për shembull kur shtypi me shpejtësi rebelimet në Egjipt dhe Babiloni. Por ashtu si babai i tij, edhe mbreti i ri pa se gjeti grekët

ishin një kockë fortë për t'u mposhtur.

Edhe pse e pushtoi Athinën në vitin 480 Para Krishtit, ushtria e Kserksit pësoi disfata të rënda përballë grekëve si në det (Salaminë) ashtu edhe në tokë (në Plataea dhe Mikale). Përballë realitetit se Greqia nuk do të përfshihej kurrë në perandorinë e tij, Kserksi zgjodhi të braktiste pushtimin e tij dhe të kthehej në shtëpi.

Dekadat që pasuan sollën grushte shteti në pallatin mbretëror, rebelime të brendshme, humbje dhe ripushtimin e Egjiptit, si dhe shtypjen e një revolte në Sidon (në Libanin e sotëm). Por pavarësisht këtyre krizave, Persia dominoi e pa kundërshtuar, derisa në vitet 330 para Krishtit, në Greqi u shfaq një figurë që do të rrëzonte të gjithë perandorinë Akamenidebrenda pak vitesh: Aleksandri i Madh.

Mbreti që u ngarkua për ndalimin e maqedonasve ishte Dari III.

Fakti që ai dështoi ta bënte këtë ishte një njollë në reputacionin e tij. Por në realitet Dari ishte një ushtar i guximshëm dhe një administrator i aftë, që përbënte një kërcënim serioz për ëndrrat e Aleksandrit për lavdi.

Por as ai nuk mundi të parandalonte dy humbje të mëdha ndaj Aleksandrit në betejë.

Në Isus në vitin 333 Para Krishtit, dhe në Gaugamela në vitin 331. Pas disfatës së dytë, Dariu arratis në Ekbatana në Iranin Perëndimor, në përpjekje për të mbledhur trupa të reja, dhe prej andej në Baktria, ku u vra nga kushëriiri i tij, Besus. Vdekja e Darit në vitin 330 Para Krishtit, shënoi fundin e perandorisë perse dhe një fazë të re në historinë botërore. Një fazë ku Aleksandri i Madh, nisi të ndërtonte një perandori të madhe që do të eklipsonte edhe atë të persëve. / **History Revealed** - **Bota.al**

PAGER-at SHPËRTHYES

Si dyshohet se Izraeli përdor teknologjinë kundër armiqve të tij

Një valë shpërthimesh vdekjeprurëse në Liban dhe pjesë të Sirisë ka vënë në shënjestër zyrtarët e Hezbollahut, pager-at e të cilëve janë hedhur në erë. Një ekspert bombave sugjeron se mund të ishin vendosur eksplozivët në pager-a.

Izraeli akuzohet për kryerjen e një sulmi të guximshëm, të teknologjisë së lartë dhe të targetuar ndaj Hezbollahut. Shpërthimi masiv i paprecedentë i pagerëve të përdorur nga luftëtarët e Hezbollahut erdhi pasi grupi ushtarak hoqi dorë nga telefonat celularë si mjet komunikimi, për të zvogëluar rrezikun e gjurmimit nga Izraeli. Askush nuk e ka marrë përgjegjësinë, por zyrtarët libanezë kanë akuzuar Izraelin, i cili nuk ka komentuar mbi shpërthimet. Ka një histori të gjatë që Izraeli akuzohet për shpikjen e metodave të reja për të eliminuar armiqtë e tij.

Si mund të vendoseshin pager-at si bomba

Një ekspert sigurie, duke folur në kushte anonimiteti, i tha Sky News se dikush mund të kishte kompromentuar këto pajisje përpara se të shpërndaheshin – si për shembull duke fshehur eksplozivë brenda tyre që mund të shpërthejnë nga distanca kur një sinjal i caktuar dërgohet në pager.

Pager-at janë përdorur përpara telefonave celularë dhe tani janë të pazakonshëm në shumicën e vendeve perëndimore, por ata përdorshin gjerësisht në vitet

1980 dhe 1990.

Ato janë pajisje komunikimi njëkahëshe, që u mundëson njerëzve të dërgojnë një mesazh të shkurtër nëpërmjet sinjalit të radios tek pager-i. Shpesh, në të kaluarën, ka qenë një numër telefoni që i ftonte njerëzit të telefononin përsëri. Burimi tha se “pikëpamja e përgjithshme që po dëgjoj është se ky ishte një sulm mbresëlënës”, i cili kërkonte një sasi të caktuar koordinimi.

“Duket e mundshme që pager-at



Historia e gjatë e Izraelit në luftën me teknologji të lartë

që ata [Hezbollahu] blenë mund të jenë kompromentuar dhe janë kthyer në bomba në distancë,” tha eksperti i sigurisë, duke theksuar se ky ishte vetëm spekulim i bazuar në ekspertizën e tij. “[Ai] duket një shpërthim shumë i koordinuar dhe i fuqishëm për të mos funksionuar thjesht,” duke shtuar se kishte më pak gjasa të ishte shkaktuar nga mbinxehja e baterive.

1972: Bassam Ebu Sharif Ai u plagos në Bejrut kur hapi një



pako që përmbante një libër ku ishte vendosur një bombë e cila shpërtheu. Ai ishte zëdhënës i Frontit Popullor për Çlirimin e Palestinës (PFLP). Ai mbijetoi, por humbi disa gishta, mbeti i shurdhër në një vesh dhe i verbër në njërin sy.

1972: Mahmud Hamshari

Një përfaqësues i Organizatës për Çlirimin e Palestinës (PLO) u vra në Paris në vitin 1972, kur një bombë u vendos nën një telefon dhe u shpërtheu nga distanca.

1996: Yahya Ayyash

Ai fitoi pseudonimin “Inxhinieri” dhe me sa duket ndihmoi në zhvillimin e bombave vetëvrasëse të përdorura në konfliktin izraelito-palestinez.

2000: Samih Malabi

Një aktivist i Fatahut nga kampi i refugjatëve Kalandia jashtë Ramallahut, u vra kur një telefon celular i bllokuar shpërtheu pranë kokës së tij.

2007: Stuxnet



Një virus i fuqishëm kompjuterik

i projektuar nga inteligjenca amerikane dhe izraelite që besohet se ka çaktivizuar një pjesë kyçe të programit bërthamor iranian. Stuxnet ishte projektuar për të shkatërruar centrifugat që Irani përdori për pasurimin e uranimit si pjesë e programit të tij të armëve. Është raportuar se virus është dorëzuar në objekt nga një agjent i dyfishtë iranian që punonte për Izraelin.

2020: Mohsen Fakhrazadeh

Një shkencëtar bërthamor iranian u vra në Iran nga një mitraloz i telekomanduar i montuar në një makinë.

Z. Fakhrazadeh po udhëtonte me një automjet të blinduar së bashku me tre automjete të personelit të sigurisë kur dëgjoji ato që dukeshin si plumba që goditën makinën e tij. Pasi ai u largua nga automjeti, një Nissan i pajisur me një mitraloz të telekomanduar më pas hapi zjarr duke e vrarë. / **bota.al**



Sot përballen Prishtina - Dukagjini, të dielën derbi Drita - Ballkani

“Epoka e re”

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Në këtë fundjavë do të zhvillohet xhiroja e javës së gjashtë në Superligën e Kosovës në futboll. Sot (e premte) zhvillohet përballja në mes të Prishtinës dhe Dukagjinit, e cila do të zhvillohet në Hajvali, pasi stadiumit “Fadil Vokrri” është i mbyllur. Prishtina ka pësuar humbje në ndeshjen e fundit nga Ballkani dhe tash synon këndelljen ndaj Dukagjinit që drejtohet nga Ismet Munishi. Edhe skuadra nga Klina ka humbur nga Malisheva dhe do të përpiqet të marrë një rezultat pozitiv nga përballja me skuadrën kryeqytetas.

Të shtunën përballen Ferizaj - Llapi dhe Suhareka - Feronikeli 74, ndërsa të dielën zhvillohen dy ndeshje ku spikat derbi i kësaj xhiroje dhe i dy skuadrave pretendente për titull, Dritës dhe Ballkanit. Gjilanasit janë vendas dhe do të përpiqen ta regjistrojnë fitoren e tretë radhazi në elitën e



futbollit të Kosovës.

Në anën tjetër, suharekasit nga pesë ndeshjet e zhvilluara kanë tri fitore, një barazim dhe një humbje dhe në këtë ndeshje do të përpiqen ta ruajnë formën e mirë dhe të jenë ndër favoritët kryesorë për titull. Ndeshja tjetër është ajo në mes të Malishevës dhe Gjilanit. Të gjitha ndeshjet e kësaj xhiroje zhvillohen nga ora 15:00.

SUPERLIGA - Java 6

Të premten takohen:
Prishtina - Dukagjini

Të shtunën takohen:
Ferizaj - Llapi
Suhareka - Feronikeli 74

Të dielën takohen:
Drita - Ballkani
Malisheva - Gjilani

Gerta Hoti vazhdon karrierën në Francë

Prishtinë, 19 shtator - Gerta Hoti, një nga basketbollistet më premtuese të basketbollit të Kosovës, do të jetë pjesë e gjigantit francez Villeneuve D'ascq Esb (ESBVA), duke shënuar një hap të madh në karrierën e saj ndërkombëtare. Pas punës së madhe disaveçare, talenti i saj është vlerësuar nga një prej klubeve më të mëdha në Francë, që ka një traditë në zhvillimin e talenteve të reja. Ky transferim është një arritje e madhe jo vetëm për Gertën, por edhe për klubin e Prishtinës dhe basketbollin e Kosovës në përgjithësi, pasi tregon rritjen e nivelit të punës që bëhet me gjeneratën e reja dhe jo vetëm. Gerta do ta ketë mundësinë të luajë në një kampionat të fortë me gjeneratat e reja dhe të zhvillohet përballë lojtarëve të klasës botërore. Me këtë hap të rëndësishëm, Gerta Hoti pritet të jetë një inspirim për shumë gjenerata të reja që ëndërrojnë të kenë sukses në nivelet më të larta të basketbollit evropian dhe botëror. KBF Prishtina e falënderon Gertën për kontributin e dhënë dhe i dëshiron shumë suksese në karrierë: “Me punë një hap afër ëndrrave!”.



SHKURT

Kosova, dy pozita më lart në renditjen e FIFA-s, Shqipëria bie një

Është publikuar ranglista e re nga FIFA. Në këtë renditje kombëtarja e Kosovës në futboll ka shënuar ngritje për dy pozita. “Dardanët” nga pozita e 106 tani pozicionohen në pozitën e 104-t pas rezultateve të dy ndeshjeve në Ligën e Kombeve. Skuadra e Frano Foda humbi 0:3 kundër Rumanisë dhe fitoi kundër Qipros me rezultat 0:4. Shqipëria në fillim të këtij muaji triumfoi 2:1 ndaj Ukrainës dhe u mposht 1:0 nga Gjeorgjia në Ligën e Kombeve, gjë që i kushtoi me humbjen e një pozite në ranglistën e FIFA-s. “Kuqezinjtë” aktualisht renditen në vendin e 67. Sa iu përket 10 vendeve të para në ranglistë, ato nuk kanë ndryshuar nga renditja e fundit, me Argjentinën që është e para me 1889 pikë. Pastaj vijnë Franca, Spanja, Anglia, Brazili, Belgjika, Holanda, Portugalia, Kolumbia dhe Italia, të cilat e mbyllin “top dhjetëshen” e ranglistës së re të FIFA-s.

KB Trepça përballët sot me kampionin e Çekisë, Nymburk

Kampionia e Kosovës në basketboll, KB Trepça do të ketë një ndeshje mjaft të vështirë ndaj kampionit të Çekisë, Nymburk. Kjo ndeshje zhvillohet në kuadër të kualifikimeve për Ligën e Kampionëve. Turneu kualifikues po zhvillohet në Antalia të Turqisë. Sfidat zhvillohen të premten nga ora 13:00, sipas kohës në Kosovë. Nëse arrin në finale, Trepça do të luajë përballë fituesit të ndeshjes Levice (Sllovakia) e Kalev/Cramo (Estoni). Finalja zhvillohet të dielën nga ora 18:00. Në çerekfinale të kualifikimeve, mitrovicasit fituan ndaj kampionit të Qipros, Keravnos 82:79. Në kualifikime janë 24 skuadra, ku katër më të mirat nga çdo grup kualifikues do t'u bashkohen 28 skuadrave që tashmë janë përcaktuar për edicionin e ri. Ndeshja transmetohet në faqen zyrtare të Ligës së Kampionëve në YouTube.

Zhegrova në ‘radarin’ e Realit

Ylli i Përfaqësueses së Kosovës, Edon Zhegrova, në dy vitet e fundit ka treguar formë të lartë. Kjo ka bërë që shumë klube evropiane të shprehin interesim për shërbimet e tij. Mediumi “Radio Montecarlo” raporton se 25-vjeçari ka përfunduar në radar të Real Madridit. Gjithnjë sipas këtij mediumi, presidenti Florentino Perez është duke e përgatitur terrenin që ta transferojë ish-futbollistin e Baselit në verën e vitit 2025. Zhegrova ka kontratë me Lillen deri në vitin 2026, por nuk pritet ta respektojë atë deri në fund. Krahas Realit, interesim për Zhegrovën ka treguar edhe Manchester Unitedi. Kartoni i Zhegrovës vlen 25 milionë euro, sipas faqes së specializuar për vlerën e futbollistëve.

Laçi: Shënova në debutim, ndjesi e mrekullueshme

PRAGË, 19 SHTATOR - Qazim Laçi ka qenë protagonist i fitores së madhe 3-0 të Sparta Pragës ndaj Salzburgut në Ligën e Kampionëve. Goli i tretë i skuadrës çeke ishte pikërisht nga Laçi i cili me një lëvizje klasi shtriu mbrojtësit dhe

portierin për ta dërguar topin në rrjetën e boshatisur. Goli i tij u shpërnda në rrjetet sociale duke marrë vlerësime dhe komente të shumta, ndërsa vetë Laçi ishte në qiellin e shtatë pas përfundimit të takimit, duke folur për mediet çeke.

“Ndjesia është e mrekullueshme, fantastike. Luajta këtë kompeticion për herë të parë. Fituam dhe unë shënova gol. E gjithë skuadra luftoi. Jam krenar për të gjithë. Ishte jashtëzakonisht entuziazmuese. Goli? Kryesisht duhet ta falënderoj

Viktor Olatunxhin për mënyrën se si më pasoi. Padyshim jam i lumtur që shënova gol, por në të vërtetë dua ta uroj të gjithë skuadrën. Në këtë ndeshje e dinim që Salzburgu do ta mbante shumë topin, por ata ishin të brishtë në prapavijë.



Ata u përmirësuan në pjesën e dytë, por ne e merituar këtë fitore”, ka thënë Laçi.

Kastrioti po bëhet gati për ndeshjen e kthimit në garat evropiane

FERIZAJ, 19 SHTATOR - Kastrioti e ka nisur mbarë edicionin 2024/2025 të garave evropiane sa u takon ekipeve kosovare të hendbollit. Të shtunën në Ferizaj, në një atmosferë shumë të ngrohtë dhe para një numri të madh shikuesish, Kastrioti e mposhti skuadrën boshnjake Sloboda Tuzla me rezultat 30:29. Ferizajasit arritën të fitorja falë përkushtimit maksimal dhe luftës sportive deri në fund. Ndeshja e kthimit është në Tuzla, të dielën nga ora 18:00. Kastrioti po paraqitet në raundin e parë të Kupës Evropiane për hendbollistë. Aktualisht është në vllugun e përgatitjeve për ndeshjen e kthimit, që do të jetë sfiduese. Sukses i Kastriotit do të kishte rëndësi të madhe edhe për motivimin e skuadrave të tjera. Edhe pesë skuadra të tjera të Kosovës paraqiten në kupa evropiane këtë edicion. Kampioni të hendbollistët, Rahovec, garimin e fillon prej raundit të dytë të Kupës Evropiane. Përballë do ta ketë skuadrën nga Belgjika, Sezoens Achilles Bocholt. Ndeshja e parë është në Bocholt të Belgjikës më 19 tetor, ndërsa e kthimit më 26



tetor në Rahovec. Në raundin e dytë të Kupës Evropiane paraqitet edhe nënkampionia, Besa Famgas. Në Lovosice të Çekisë, Besa e luan ndeshjen e parë me Mesto Lovosice më 19 tetor. Në Pejë është ndeshja e kthimit më 27 tetor. Te hendbollistët, kampioni Istogu përballet me skuadrën greke Pylaia Thessaloniki në raundin e dytë të Kupës Evropiane.

Ndeshjet zhvillohen në Pejë më 12 e 13 tetor. Në të njëjtin raund garash, Ferizaj takohet me Caja Rural Aula Valladolid. Klubi ferizajas është pajtuar që dy ndeshjet t'i luajë në Valladolid të Spanjës, më 4 e 6 tetor. Samadrexha paraqitet në raundin e dytë të Kupës Evropiane. Më 12 e 13 tetor në Portugali përballet me skuadrën Colegio Gaia/Colgaya-Toyota.

SHKURT

Guardiola pas barazimit ndaj Interit: E dua ekipin tim

“Unë e dua ekipin tim. Më pëlqeu gjithçka, por ekipi që kishim përballë nuk është rastësisht kampion i Italisë. Është një skuadër e shkëlqyer, që luan shumë mirë në kundërsulm dhe që mbrohen mirë”. Me këto fjalë e nisi Pep Guardiola konferencën për shtyp pas barazimit ndaj Interit. Strategu spanjoll është i kënaqur se ekipi i tij luan bashkë në sulm dhe mbrojtje, derisa përmendi edhe pesë rastet e krijuara për gol. “Kemi luajtur më mirë sesa në finalen e Stambollit. Në pjesën e dytë kishim të paktën 4-5 raste për gol, ndërsa ata vetëm një rast në fund me Lautaron. Nuk kishte asgjë që nuk më pëlqeu në këtë ndeshje. Jam shumë i lumtur që mund të sulmoj me 11 lojtarë, të gjithë sulmojnë, mbrojnë, rikuperojnë topa. Në nivele të tilla nuk mund të krijosh 20 raste për gol, në krijuam 5, luajtëm mirë, por nuk fituam”, ka deklaruar Guardiola.

Inzaghi: Luajtëm mirë ndaj Cityt

Trajneri i Interit, Simone Inzaghi, pas këtij barazimi pa gola në “Etihad”, është ndarë i kënaqur me lojën e futbollistëve të tij. Ai ka thënë se në 30 metrat e fundit duhet të punojë më shumë ekipi. “Djemtë u treguan të zotë, punuan mirë të gjithë së bashku, nuk munguan as rastet për gol. Cfarë na mungoi? Në 30 metrat e fundit duhet të punojmë më mirë, të kemi më shumë teknikë”, u shpreh Inzaghi, duke u ndalur më pas te zgjedhja e tij për të lënë në stol Lautaro Martinez: “Unë vendos në bazë të asaj që shoh në stërvitje. Nuk ka të bëjë me rotacionin. Derbi? Do të jetë një ndeshje e ndjeshme, si gjithmonë, mbi të gjitha për tifozët. Mund të jetë edhe Dimarco, po rikuperon mirë”.

Ballack: Bayerni nuk mund të shkoj deri në finale

Ish-lojtari i Bayern Munchenit, Chelsea, Bayer Leverkusenit dhe Kombëtares së Gjermanisë, Michael Ballack ka thënë se Bayerni aktualisht nuk është një kandidat për të shkuar deri në fund të garës së Ligës së Kampionëve. “Finalja në ‘Allianz Arena’ do t’u japë të gjithëve te Bayerni edhe më shumë motivim, por ata ende duhet të tregojnë se janë edhe kandidatë për këtë finale. Për momentin nuk do ta emëroja si një nga kandidatet e para për në finale”, ka thënë Ballack në një intervistë për “Kicker”. “Bavarezët” do të luajnë në fazën e grupeve të Ligës së Kampionëve së bashku me Parisin, Barcelonën, Dinamo Zagrebin, Aston Villan, Benficën, Shakhtarin, Feyenoordin dhe Slovan Bratislavan. Ballack beson se ky raund paraprak në Ligën e Kampionëve do të jetë pikë referimi për mbrojtjen e Bayernit, e cila u kritikua mjaft paraprakisht. Por, gjithashtu, besoj se javë pas javë në Bundesligë ka një mundësi për t’i larguar dyshimet që shpesh janë shprehur për përbërjen e skuadrës: “Sidomos në mbrojtje, kishte disa vendime që sigurisht mund të ishin marrë ndryshe dhe që shumë tifozë ndoshta do t’i kishin marrë ndryshe. Përgjegjësit e kanë zgjidhur ndryshe dhe sigurisht që ka arsye për këtë. Po flas qartë për aspektin financiar”.

Verstappen: Fitojmë e humbasim të gjithë si ekip

Singapore, 19 shtator - Nuk ka pushim për Formula 1, që këtë fundjavë do të spostohet në Singapor, në pistën qytetase. Në një garë spektakolare me drita. Piloti holandez i Red Bull Racing, Max Verstappen, shpreson të rikthehet te fitorja, që mungon prej disa muajsh, ndërkohë që tashmë ka vetëm 59 pikë avantazh ndaj Lando Norris. “Ne mësuam nga gabimet e javës së kaluar në Baku dhe mund të provojmë disa gjëra ndryshe këtë fundjavë në Singapor. Marina Bay është një circuit fantastik, por presim që të jetë pak më sfidues, siç ka qenë gjithmonë në të kaluarën. Gara



zakonisht është shumë e ngushtë këtu dhe padyshim shumë e nxehtë dhe e lagësht”, ka thënë Max Verstappen. “Ndryshimet që

bëmë fillimisht në Baku ishin pozitive dhe ne po shkonim në drejtimin e duhur. Ne mendojmë se e dimë se çfarë mund të bëjmë më mirë dhe padyshim që duhet të sigurohemi që ta optimizojmë strukturën tonë”, u shpreh më tej tri herë kampioni i botës. Në fund ai shtoi: “Do të jetë e rëndësishme ta mbajmë kontrollin e makinës pak më shumë me shpejtësi të ulët në mënyrë që të ngjitet më shumë me asfaltin dhe kjo duhet të na ndihmojë shumë në fund. Ne po luftojmë për kampionatin: fitojmë dhe humbasim si ekip dhe do të vazhdojmë të shtyjmë për t’i rikthyer më të fortë”.

Futbollistët e Romës, mesazhe emocionuese për De Rossin: Futbolli është i padrejtë

Daniele De Rossi është shkarkuar nga Roma pas vetëm katër ndeshjeve në sezonin e ri. Ky lajm ka qenë një shok për futbollistët e Romës, të cilët nuk ishin në dijeni për shkarkimin e trajnerit të tyre. Të gjithë futbollistët e klubit

italian kanë shkruar mesazhe emocionuese në rrjetet sociale duke falënderuar legjendën italiane. “Zotëri, nuk kanë kaluar shumë muaj, por ka mjaftuar për të na përcjellë shumë gjëra në nivel sportiv dhe njerëzor. Futbolli shpesh

është i padrejtë... faleminderit për gjithçka dhe ju uroj më të mirën për veten tuaj në të ardhmen”, ka shkruar Dybala. Mesazh shumë emocionues ka shkruar edhe portieri Mile Svilar, ku De Rossi ishte trajneri që i dha besimin dhe e vendosi

si titullar te Roma. “Faleminderit që ma ndryshove jetën. Do të jem gjithmonë mirënjohës”, ka shkruar Svilar. “Faleminderit për gjithçka që keni bërë dhe keni qenë gjithmonë me mua... Ishe pikë referimi që i vogël,

bashkëlojtar, mik, kapiten dhe trajner. Të uroj më të mirat sepse e meriton si burrë dhe si profesionist dhe jam i sigurt se do të arrish gjithçka që dëshiron. Sukses trajner! Të dua Daniele!”, ka shkruar kapiteni Lorenzo Pellegrini.

Enis Vila: Nëse ftohëm nga Kosova, jam i gatshëm ta jap maksimumin

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Futbollisti 22-vjeçar Enis Vila me prejardhje nga Hani i Elezit, i cili luan në LandesLiga në Gjermani për klubin më të suksesshëm shqiptar në Gjermani, FC Kosova Dusseldorf, ka një karrierë të bujshme në futbollin gjerman. Vila që në moshën pesëvjeçare ka luajtur në klubin gjerman Ratingen wes e ku më pas ka luajtur edhe në Bundesliga në ekipe të ndryshme si Unterrath Dusseldorf për grupmoshat U15/16/17 si dhe për ekipin e Oberhausen dhe Dusiburg me grupmoshat U19. Enis Vila me kapacitete që i ka beson dhe shpreson se një ditë do të ftohet edhe nga kombëtarja e Kosovës e që thotë se është i gatshëm ta japë maksimumin për shtetin e Kosovës.

“Epoka e re”: Enis Vila, kur keni filluar karrierën futbolistike?

Vila: Unë karrierën futbolistike e kam filluar në moshën pesëvjeçare, në vitin 2007, me Ratingen west. Kam pasur dëshirë të madhe të luaj futboll. Pasi isha edhe në shkollë, atëherë u regjistрова në klub dhe aty fillova të ushtrorj e të luaj për pesë

çdoherë kam pasur dëshirë dhe e kam gjetur veten më mirë si mbrojtës i qendrës. Ndërsa nga lojtarët e huaj idol e kam Cristiano Ronaldo. Ai është lojtar i madh dhe i pazëvendësueshëm.

“Epoka e re”: Cilat janë klubet që ke luajtur deri tani, përfshirë ato si amator dhe tani këto si profesionist?

Vila: Klubi im i parë ka qenë Ratingen west. Aty kam luajtur për pesë vjet, e ku më vonë kam kaluar në Unterrath Dusseldorf. Në këtë klub kam luajtur U15\16\17 në Bundesliga. Më pas në Bundesliga kam luajtur edhe si U19, por tani në skuadrën Oberhausen, po ashtu kam luajtur edhe për Dusiburg U19 në Bundesliga deri në vitin 2021. Më pas kam luajtur një vit në Oberliga për ekipin Baumberg. Në këtë ligë ishte në atë kohë edhe ekipi shqiptar FC Kosova Dusseldorf dhe babai im më ka tërhequr nga ky klub dhe më ka dërguar në ekipin shqiptar. Unë jam pajtuar me propozimin e babait tim Muhamet Vila, i cili është një veprimtar i shquar i çështjes kombëtare dhe kam



por edhe karriera ime ka mbetur e dëmtuar.

“Epoka e re”: Në vitin 2021 ju keni vizituar Federatën e Futbollit të Kosovës. A jeni ftuar nga kryetari Agim Ademi që të luani për Kosovën në atë kohë?

Vila: Po në vitin 2021 jam ftuar nga Federata e Kosovës dhe jam prituar në zyrën e kryetarit të Federatës, Agim Ademi. Aty kam marrë ftesë t'u bashkohem U21-shave të Kosovës, por lëndimi më ka lënë jashtë grumbullimeve, kështu që tani e kam kaluar



moshën dhe po pres se çfarë po ndodh.

“Epoka e re”: Tani po luani në Klubin FC Kosova Dusseldorf në LandesLiga dhe jeni një prej lojtarëve kyç të ekipit. A pritni t'i arrini objektivat e klubit që të ngjiteni edhe më lart në ligën e Gjermanisë?

Vila: Në klubin FC Kosova Dusseldorf jam që nga viti 2022 dhe jemi ngritur në një rang më lart në ligën gjermane. Jemi duke ecur me hapa të sigurt që të ngrihem edhe në një ligë më lart. Kemi një staf të mrekullueshëm në krye me presidentin e klubit, Bujar Neziri, një trajner të jashtëzakonshëm dhe lojtarë mjaft cilësorë në ekip. Jemi shumë kompaktë dhe i dimë objektivat tona. Kemi sponsorë kryesisht shqiptarë, por kemi shikues e mbështetës shumë, ndoshta më së shumti në këtë ligë nga të gjitha ekipit që marrim pjesë në këtë kompeticion.

“Epoka e re”: Përfaqësuesja e Kosovës po drejtohet nga gjermani Foda. Si po ju duket koncepti i lojës së Kosovës? A mendon se do ta fusë frymën gjermane në ekip?

Vila: E përcjell me shumë kënaqësi kur luan Kosova dhe shoh që edhe ekipi i Kosovës është ngritur në nivelin evropian, por kam dëshirë të arrijë sa më shumë suksese, sepse një reprezentacion i fortë e bën edhe Kosovën më të dëshiruar në Evropë. Trajneri gjerman mendoj se ka dëshirë ta fusë filozofinë gjermane brenda ekipit dhe besoj se kjo është gjë e duhur. Shqiptarët në përgjigjësi kanë mentalitet gjerman sa i përket aspektit futbolistik, sepse nuk dorëzohen. I dëshiroj shumë suksese Kosovës dhe trajnerit Foda.

“Epoka e re”: A jeni i gatshëm t'i përgjigjeni pozitivisht ftesës nga Kosova?

Vila: Jam i gatshëm çdoherë t'i përgjigjem ftesës së Kosovës, vendlindjes së babait tim, i cili ka kontribuar shumë që sot Kosova të ketë mundësi të luajë në arenën ndërkombëtare. Sigurisht që stafi i selektorit merret me zbulimin e talentëve që i nevojiten Kosovës, por disa lojtarë besoj se jemi të duhur të ftohemi dhe të na jepet mundësia ta tregojmë veten. Kosovën gjithmonë e kam zgjedhjen e parë.



vjet radhazi. Tani jam 22-vjeçar, por kurrë nuk e harroj skuadrën e parë ku edhe i kam marrë hapat e parë të lojës së futbollit.

“Epoka e re”: Nga kush jeni inspiruar të merreni me futboll?

Vila: Idoli im dhe i gjithë shqiptarëve me siguri nga lojtarët shqiptarë ka qenë Fadil Vokrri. Ne si fëmijë kemi pasur dëshirë të bëhemi sikur Vokrri. Edhe pse Vokrri ka qenë sulmues, unë

dashur t'i ndihmoj klubit të shqiptarëve. Edhe sot jam pjesë e këtij klubi.

“Epoka e re”: Para disa vjetësh keni pësuar një lëndim që ju ka lënë jashtë fushës shumë kohë. Sa ka ndikuar në karrierën tuaj ky lëndim?

Vila: Po, një lëndim që e kam pësuar gjatë vitit 2021, më ka lënë jashtë fushës për disa muaj dhe aty jam dëmtuar shumë si lojtar,





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Lindja Solar" L.L.C. Brestovc, Rahovec në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Parkun solar fotovoltaik me kapacitet 100 MW në Kramovik dhe Petkoviq, Komuna e Rahovecit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 01.11.2024 në ora 10:00 në objektin e komunës së Rahovecit, do të organizohet debat publik nga Kompania "Lindja Solar" L.L.C. Brestovc, Rahovec, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për Parkun solar fotovoltaik me kapacitet 100 MW në Kramovik dhe Petkoviq, Komuna e Rahovecit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Join Zoom Meeting#

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoocSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495

Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Lindja Solar" L.L.C. Brestovc, Rahovec, për Parkun solar fotovoltaik me kapacitet 100 MW në Kramovik dhe Petkoviq, Komuna e Rahovecit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emailin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Jasmina Rahmani shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Gani Saramati" Prizren .

Bahti Hajdari shpall te pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

Vahid Gigollaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit.

Brikena Karricaj nga Novosella KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Mentor Hakif Mustafa shpall të pavlefshme certifikatën me nr. 50/2005 të lëshuar nga Qendra e Aftësisimit Profesional në Mitrovicë, ndërtimtari, organizim të punës, siguri punës, vizatim teknik, matjen e objektit, betonim, muratim, suvatim.

- Qerfime Rama shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Xhevat Jusufi" ish shkolla fillore "Rifat Vidishiqi".

- Bedrije Deliu shpall te pavlefshme 3 dëftesat e shkollës se mesme "Frang Bardhi".

- Alban Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari".

- Zana Rama nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4. dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Jasmina Rahmani shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Gani Saramati" Prizren .

Bahti Hajdari shpall te pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

Vahid Gigollaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit.

Brikena Karricaj nga Novosella KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Mentor Hakif Mustafa shpall të pavlefshme certifikatën me nr. 50/2005 të lëshuar nga Qendra e Aftësisimit Profesional në Mitrovicë, ndërtimtari, organizim të punës, siguri punës, vizatim teknik, matjen e objektit, betonim, muratim, suvatim.

- Qerfime Rama shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Xhevat Jusufi" ish shkolla fillore "Rifat Vidishiqi".

- Bedrije Deliu shpall te pavlefshme 3 dëftesat e shkollës se mesme "Frang Bardhi".

- Alban Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari".

- Zana Rama nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4. dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

